



Strategjia për Shqipërinë

2020-2025

Miratuar nga Bordi i Drejtorëve në 12 Shkurt 2020



European Bank
for Reconstruction and Development



Përkthimi i këtij teksti nga dokumenti origjinal është siguruar nga BERZH vetëm për lehtësi të lexuesit. Ndërsa BERZH ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar autenticitetin e përkthimit, BERZH nuk garanton e as vërteton saktësinë e përkthimit. Marrja për bazë e këtij përkthimi është zgjedhje e vetë lexuesit. Në asnjë rrethanë, BERZH, punonjësit apo agjentët e saj nuk do të mbajnë përgjegjësi ndaj lexuesit apo çdo personi tjetër në lidhje me pasaktësi, gabime, heqje, fshirje, të meta dhe/ose çdo devijim të përmbajtjes së përkthimit, pavarësisht shkakut, apo për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e tij. Në rast të ndonjë mospërputhjeje apo kundërshtie midis variantit në anglisht dhe variantit të përkthyer, varianti në anglisht do të ketë përparësi.

Përmbajtja dhe Fjalori



European Bank
for Reconstruction and Development

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	4
Shqipëria – Panoramë e BERZH	5
I. Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme - 2015-2019	6
Rezultatet Kryesore të Tranzicionit të Arritura gjatë Periudhës së Strategjisë së Mëparshme	6
Sfidat gjatë Zbatimit dhe Mësimet Kyçe	8
II. Konteksti Ekonomik	9
Konteksti Makroekonomik dhe Parashikimi për Periudhën e Strategjisë	9
Sfidat Kryesore të Tranzicionit	10
III. Përparësitë e Qeverisë dhe Angazhimi i Palëve të Interesit	12
IV. Përcaktimi i Përparësive të Strategjisë së BERZH për Shqipërinë	13
V. Kuadri i Aktiviteteve dhe Rezultateve	14
VI. Harta e Aktiviteteve Plotësuese të Partnerëve Ndërkombëtarë në Fushat e Veprimtarisë së BERZH	17
VII. Risqet e Zbatimit dhe Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	18
VIII. Vlerësimi i Bashkëfinancimit nga Donatorët	19
Shtojca 1 - Vlerësimi Politik	20

Fjalor i Termave Kyç

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional	NKIM	Nisma për Klimën e Investimeve dhe Mirëqeverisje
AT	Asistencë Teknike	NPrT	Ndikimi i Pritshëm në Tranzicion
AVI	Aktiviteti Vjetor i Investimeve	NPT	Ndikimi i Portofolit në Tranzicion
AZZH	Asistenca Zyrtare për Zhvillim	NSH	Ndërmarrje Shtetërore
BB	Banka Botërore	ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
BE	Bashkimi European	OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
BEI	Banka Europiane e Investimeve	OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim	PLT	Programi i Lehtësimit të Tregtisë
BNJ	Burimet Njerëzore	PPP	Partneritet Publik Privat
BT	Bashkëpunim Teknik	PVQGJ	Plani i Veprimtimit të Qyteteve të Gjellbra
EJL	Europa Juglindore	SECO	Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike
FEB	Forumi Ekonomik Botëror	SH&S	Shëndeti dhe Siguria
FPPE	Furnizimi i Përgjithshëm me Energji Parësore	SMVM	Sipërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
IAP	Instrumenti për Asistencë Para-Anëtarësimit	SVM	Sipërmarrje të Vogla dhe të Mesme
IF	Institucion Financiar	TAP	Gazsjellësi Trans Adriatik
IFN	Institucion Financiar Ndërkombëtar	TEGJ	Tranzicioni në Ekonomi të Gjellbër
IFP	Institucion Financiar Partner	TIK	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
IHD	Investime të Huaja Direkte	TMD	Teknologjia më e Mirë e Disponueshme
IIBP	Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor	ViV	Vendi i Veprimtarisë
IMASH	Instrumenti i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar	VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ITA	Industria, Tregtia dhe Agrobiznesi	VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
K&ZH	Kërkim dhe Zhvillim	ZGV	Zinxhiri Global i Vlerës
KBV	Këshillim për Biznesin e Vogël		
KFN	Korporata Financiare Ndërkombëtare		
KMP	Kredi me Probleme		
KP	Kërkesë Performance		
M&S	Mjedisor dhe Social		

Angazhimi i Shqipërisë ndaj parimeve politike të përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për Krijimin e Bankës dhe zbatimi i tyre, kanë vijuar që prej miratimit të Strategjisë së mëparshme për Vendin, në përputhje me përpjekjet për zbatimin e agjendës gjithëpërfshirëse të përafrimit me BE-në. Kjo është shtysa kryesore e jashtme për reformat, përfshirë edhe ato që lidhen me forcimin e qeverisjes dhe sundimit të ligjit, ku ka ende sfida serioze.

Gjatë katër viteve të shkuara vendi ka treguar prirje rritëse të PBB-së, e kryesuar kryesisht nga konsumi, dhe një ripërtëritje të investimeve si pasojë e dy IHD-ve të mëdha në sektorin e energjisë. Që të përshpejtojë përafrimin me nivelin e të ardhurave të BE-së, Shqipëria duhet të rrisë prodhimtarinë, duke e transferuar modelin e rritjes nga konsumi tek investimet dhe eksportet, veçanërisht kur merren parasysh zhvillimet jo të favorshme demografike lidhur si me emigrimin ashtu edhe me urbanizimin e shpejtë të Tiranës. Nevojitet klimë e përmirësuar biznesi për të mbështetur diversifikimin dhe tërheqjen e IHD-ve, sidomos në sektorë si turizmi, prodhimi dhe agrobiznesi, me qëllim mundësimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Mangësitë e tranzicionit mbeten serioze në të gjashtë cilësitë e tranzicionit drejt një ekonomie tregu moderne, siç përkufizohen nga BERZH. Mirëqeverisja dhe konkurrueshmëria do të përfitonin nga adresimi i ekonomisë informale të shumëpërhapur, si dhe nga forcimi i institucioneve. Kostot e ulëta të fuqisë punëtore mbështesin konkurrueshmërinë, por zhvillimi ekonomik pengohet nga mungesa e aftësive dhe mospërputhja e tyre me nevojat e tregut, pasiguria lidhur me të drejtat mbi tokën dhe pronën, mungesa e njohurive dhe sofistikimit të biznesit, investimet e pakta në K&ZH, dhe kapaciteti i dobët për inovacion. Sektori financiar vijon të ketë nivele të larta Euroizimi dhe mbizotërohet nga banka me kapital dhe likuiditet të mirë, me KMP relativisht të larta dhe huadhënie të ulët ndaj sektorit privat, ndërkohë që tregjet e kapitalit mbeten të pazhvilluara. Me gjithë investimet e konsiderueshme në infrastrukturë rrugore gjatë viteve të fundit, rrjetet e transportit vijnë të kenë nevojë për përmirësime të mëtejshme të konsiderueshme. Sektorit publik i nevojitet fuqizimi i kapaciteteve për planifikimin dhe zbatimin e investimeve, përfshirë ato lidhur me PPP-të. Prodhimi i energjisë elektrike në vend vijon të mbështetet thuajse plotësisht në hidrocentrale dhe ka nevojë urgjente për diversifikim për të shmangur rrezikun nga ndryshimet klimatike. Elementë të tjerë kyçë për tranzicionin e vendit drejt ekonomisë së gjelbër janë rritja e investimeve për efikasitet të energjisë dhe ujit, përmirësime thelbësore në administrimin e mbetjeve, dhe investimet në ekonominë qarkulluese.

Banka është e mirë-pozicionuar për të adresuar mangësitë e tranzicionit duke financuar investime me objektiva të qarta, dhe duke mbështetur përpjekjet për reforma në bashkëpunim të ngushtë me BE-në, IFN të tjera dhe donatorët. Përqendrimi i vëmendjes në forcimin e qeverisjes duhet të mbështesë investime në sektorin publik të planifikuara dhe administruara më mirë, si dhe të ndihmojë ristrukturimin dhe komercializimin e NSH-ve. Në sektorin privat duhet të ketë kontribut në përmirësimin e klimës së biznesit dhe mundësimin e formalitetit më të lartë, diversifikimin dhe tërheqjen e IHD-ve. Banka do të asistojë gjithashtu edhe me adresimin e cenueshmërive nga ndryshimet klimatike (veçanërisht duke diversifikuar burimet e prodhimit të energjisë elektrike), përmirësimin e infrastrukturës dhe përmirësimet në ndërlidhjet vendore dhe rajonale, përfshirë edhe nëpërmjet IIBP-së.

Banka do të përqendrohet në këto përparësi në Shqipëri, gjatë periudhës 2020-2025:

- *Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes në të gjithë ekonominë;*
- *Përmirësim i konkurrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes së sektorit privat përmes qasjes më të madhe në financim dhe aftësi;*
- *Përforsim i diversifikimit të energjisë dhe tranzicionit drejt niveleve të ulta të karbonit*

Shqipëria – Panoramë e BERZH




European Bank
for Reconstruction and Development


Veprimtaritë e Investimit të BERZH në Shqipëri (deri në dhjetor 2019)

Portofoli	722 mil €	Projekte aktive	46
Pjesa e investimeve në kapital	2%	Aktive në Veprim	420 mil €
Pjesa Private ¹	56%	Investim neto kumulativ	1,397 mil €


AVI dhe Operacionet




Përbërja e Portofolit



Dinamika e Portofolit



Mangësitë e Tranzicionit²



Shifrat Kontekstuale të Shqipërisë

	Shqipëria	Krahasimet
Popullata (milion) ³ (2018)	2,9	B dhe H (3,5) Maqedonia e Veriut (2,1) Serbia (7,0)
PBB për frymë (PPP, USD) ³ (2018)	13.327	B dhe H (13.583) Maqedonia e Veriut (15.715) Serbia (17.552)
Indeksi Botëror i Konkurrueshmërisë (WEF) (2019)	e 81-ta (nga 141)	B dhe H (92) Maqedonia e Veriut (82) Serbia (72)
Papunësia (%) ⁴ (2018)	15,1	B dhe H (26,1) Maqedonia e Veriut (22,3) Serbia (13,1)
Papunësia e Rinisë (%) ⁴ (2018)	32,7	B dhe H (55,5) Maqedonia e Veriut (47,2) Serbia (31,3)
Pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore (%) ⁴ (2018)	47,0	B dhe H (35,1) Maqedonia e Veriut (42,5) Serbia (45,6)
Intensiteti i energjisë (TPES/PBB) ⁵ (2016)	0,17	B dhe H (0,4) Maqedonia e Veriut (0,2) Serbia (0,4)
Intensiteti i shkarkimeve/PBB (kgCO2/10' \$) ⁵ (2016)	0,3	B dhe H (1,2) Maqedonia e Veriut (0,6) Serbia (1,1)


¹ Investimet e Bankës Gjithsej: Bazë 5 vjeçare ripërtëritëse e portofolit. ² Cf. Raporti i Tranzicionit i BERZH 2018-2019. ³ IMF WEO. ⁴ Vlerësimi Organizatës Ndërkombëtare të Punës. ⁵ Atlasi i Energjisë i IEA. ⁶ Kanada, Republika Çeke, Franca, Gjermania, Japonia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara

1. Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme (2016-2019)




European Bank
for Reconstruction and Development

1.1. Rezultatet Kyçe të Tranzicionit të arritura nën Strategjinë e mëparshme të Vendit



Përparësia 1: Mbështetje e konkurrueshmërisë së sektorit privat duke zgjeruar krijimin e vlerës, lehtësuar qasjen e SVM-ve në financim dhe forcuar një mjedis mundësues biznesi



* Performanca e ndikimit në tranzicion pasqyron gjasat që kanë projektet për të arritur ndikimin në tranzicion që pritet kur ato nënshkruhen. Përllëgaritur bazuar në portofolin aktiv të maturuar (> 2 vjet)

1. Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme (2016-2019)




European Bank
for Reconstruction and Development

1.1. Rezultatet Kyçe të Tranzicionit të arritura nën Strategjinë e mëparshme të Vendit

Përparësia 2: Zgjerimi i tregjeve përmes forcimit të lidhjeve rajonale

Rritje e shitjeve të KBV




Rezultatet Kyçe të Tranzicionit

- U nënshkrua projekti TAP, një projekt themelor infrastrukture në rajon që çel mundësinë e përdorimit të gazit në Shqipëri. Përmes këtij projekti dhe një programi gjithëpërfshirës asistence teknike për OST-në e sapo krijuar të gazit (Albgaz), patëm një rol kyç edhe në përmirësimin e aftësive dhe krijimin e një kuadri rregullator në sektorin e gazit, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Vijoi angazhimi aktiv në zhvillimin e infrastrukturës vendase të gazit, përfshirë edhe si IFN kryesuese në një sërë projektesh të mbështetur nga IIBP-ja.
- U mbështet përgatitja e projekteve si IFN kryesuese, u mobilizua një grant investimesh i IIBP-së dhe u nënshkrua një hua sovranë për Hekurudhën Shqiptare për linjën Durrës-Tiranë-Aeroporti Rinas. Kjo është pjesë e korridorit që lidh portin e Durrësit me rajonin, dhe investimi i parë në hekurudhën e vendit që prej fillimit të tranzicionit. Projekti përfshin AT të gjerë për të ngritur kapacitetet dhe për të përmirësuar raportimin financiar të Hekurudhës Shqiptare.
- U realizuan arritje të rëndësishme në reformë në kuadrin e projekteve sovranë të rrugëve, u mbështet përgatitja e një Plani të Qëndrueshëm Transporti dhe një Strategjie për Taksimin Rrugor, dhe vijoi zbatimi i projektit të Bajpaseve të Fierit dhe Vlorës.
- U nënshkrua një hua prej 25 mil € në mbështetje të një investimi përtej kufijve të një grupi shqiptar në një fabrikë ferronikeli në Kosovë.
- U zhvillua një program financash tregtare në Shqipëri, përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje kuadër me Union Bank me vlerë prej 5 mil € dhe një marrëveshje kuadër me vlerë 10 mil € me OTP Bank.
- U mbështet Qendra Kombëtare e Biznesit në procesin e aderimit në Portalin Rajonal të Regjistrave të Biznesit.

Përparësia 3: Promovimi i qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve publike përmes komercializimit dhe pjesëmarrjes së sektorit privat.

Energjia e kursyer



Rezultatet Kyçe të Tranzicionit

- U nënshkrua dhe vendos në dispozicion huaja e ristrukturimi me KESH prej 218 mil €, nga të cilat kësti i parë prej 118 mil € është disbursuar pas progresit thelbësor në kushtet e vendosura për reformë në nivel sektori dhe kompanie. Përmes një pune të gjatë dialogu dhe asistence teknike, u mbështet edhe përgatitja dhe zbatimi i një Plani për Menaxhimin e Rreziqeve Klimatike që synon përmirësimin e aftësisë tregtare dhe kapacitetit strategjik të KESH, dhe i një Plani gjithëpërfshirës Veprimi për Qeverisjen e Korporatës. U vijua puna në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe IFN të tjera për të çuar përpara reformat e sektorit të energjisë në përputhje me Direktivat e BE-së.
- U ndërmor dialog politikash që rezultuan në miratimin e Ligjit për Performancën e Energjisë së Godinave, përmes Programit Rajonal të Eficiencës së Energjisë të mbështetur nga BE. Kjo hodhi themelet për harmonizimin e mëtejshëm të kuadrit legjislativ, si edhe për investime në sektorin e ndërtimit.
- U mbështet Qyteti i Tiranës përmes angazhimit të gjerë për politika dhe AT, për përgatitjen dhe miratimin e Planit të Veprimi të Qytetit dhe Gjelbra (PVQGJ), që përcakton prioritetet dhe strategji për adresimin e sfidave mjedisore të qytetit.
- U nënshkrua një hua 15 mil € për Ujësjellës Kanalizime Tiranë, si projekti i parë në kuadër të PVQGJ-së për Tiranën dhe financimi i parë me terma tregtare nga një IFN për një ndërmarrje utilitare bashkiake në Shqipëri. Projekti u mundësua nga rritja e tarifave të ujit dhe shoqërohet me një AT gjithëpërfshirëse për përf forcimin e kapaciteteve të Ujësjellës Kanalizime Tiranë.
- Nisi dialogu i politikave dhe AT për zhvillimin e energjisë diellore, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare, dhe rritjen e qëndrueshmërisë së një sistemi që mbështetet thajse vetëm në energji hidrike. Këtu përfshihet mbështetje ndaj Qeverisë për zhvillimin e proceseve për shpërndarje konkurruese të kapaciteteve të prodhimit të energjisë diellore.

1. Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme (2016-2019)



European Bank
for Reconstruction and Development

1.2. Sfidat gjatë Zbatimit dhe Mësimet e Kyçe

Konteksti i zbatimit: Shqipëria vijon të ketë mangësi të konsiderueshme tranzicioni. Prodhimi me vlerë të shtuar të ulët përbën një pjesë të madhe të ekonomisë dhe ndërmjetësimi financiar mbetet i kufizuar. Përafrimi me BE-në është shtysa kryesore e jashtme për kryerjen e reformave, përfshirë edhe ato që lidhen me forcimin e qeverisjes dhe sundimit të ligjit, ku ka ende sfida serioze. Megjithatë progresi i reformës për mjedisin e biznesit ka luhatje, rritja ekonomike ka qenë e mirë dhe e nxitur nga dy IHD të mëdha në fushën e energjisë. Konsolidimi i sektori bankar gjithashtu ka ecur përpara gjatë periudhës së strategjisë së mëparshme. Besimi në sektorin bankar është rritur me rënien e KMP-ve dhe bankat vijnë të kenë kapital të mirë dhe likuiditet të lartë.

Sfidat gjatë Zbatimit

- Korrupsioni dhe informaliteti mbeten pengesat kyçe ndaj zhvillimit të biznesit dhe investimeve të huaja. Zbatimi i dobët i ligjit dhe të drejtat e paqarta të pronësisë ndikojnë edhe në sektorët e turizmit dhe agrobiznesit, që janë shtysat kryesore të rritjes ekonomike.
- Qasja në financim mbetet e kufizuar. Megjithatë bankat kanë likuiditet të lartë, rritja e huadhënies mbetet e dobët.
- Konkurrueshmëria e sektorit privat dhe integrimi rajonal pengohen nga gjendja e dobët e infrastrukturës së transportit.
- Qëndrueshmëria afatgjatë e sektorit të energjisë kërkon reforma ambicioze, përfshirë edhe disiplinë më të madhe operacionale nga ana e NSH-ve.
- Diversifikimi i burimeve të energjisë (aktualisht mbizotëruar nga ato hidrike) është nevojë urgjente për rritjen e rezistueshmërisë së sistemit.
- Ofrimi i shërbimeve bashkiake është i papërshtatshëm, ndërsa sektori mbetet tejte i qendëruar.

Mësimet Kyçe dhe Hapat e Ardhshëm

- Nevojitet vëmendje më e madhe ndaj mirëqeverisjes, përmirësimit të klimës së biznesit dhe angazhimit me sektorin privat, në koordinim të ngushtë me BE-në, IFN-të e tjera dhe donatorët. Nisma për Klimën e Investimit dhe Mirëqeverisjen mund të jetë një instrument efektiv për angazhimin e gjerë në politika në këtë fushë që mund të sjellë rezultate të prekshme.
- Banka mund të ndihmojë me zhblokimin e më shumë huadhënieje, edhe përmes produkteve të pafinancuara të ndarjes së rrezikut.
- Nevojiten ende investime të konsiderueshme, që do të mbështeten në kuadër të IIBP-së, për të përmirësuar rrjetin rrugor, për të zhvilluar mundësitë e plota të porteve dhe aeroporteve të vendit dhe për të ringritur një sistem funksional hekurudhor.
- Angazhimi në politika dhe investimet në sektorin e energjisë në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe IFN-të e tjera mund të sjellin rezultate të konsiderueshme dhe të tërheqin IHD.
- Banka është në pozicionin e duhur për të mbështetur zhvillimin e tregut për burime të tjera të rinovueshme (sidomos diellore), ndërsa TAP-i mund të krijojë mundësi për gjenerim energjie nga gasi.
- Nisma e Qyteteve të Gjëlbra në Tiranë ka siguruar një platformë të fuqishme për investime në infrastrukturën bashkiake.

2. Konteksti Ekonomik



European Bank
for Reconstruction and Development

2.1 . Konteksti Makroekonomik dhe Parashikimi për Periudhën e Strategjisë

Shqipëria - Treguesit kryesorë makroekonomikë

	2014	2015	2016	2017	2018
Rritja e PBB-së (% v në v)	1,8	2,2	3,3	3,8	4,1
Inflacioni i IÇK (% mesatarisht)	1,6	1,9	1,3	2,0	2,0
Balanca e Qeverisë (% e PBB-së)	-5,2	-4,1	-1,8	-2,0	-1,6
Balanca e llogarive korrente (% e PBB-së)	-10,8	-8,6	-7,6	-7,5	-6,7
IHD Neto (% e PBB-së) [shenja minus = hyrje]	-8,1	-8,0	-8,7	-8,6	-8,0
Borxh i jashtëm (% e PBB-së)	69,5	74,4	73,5	68,7	65,2
Rezervat bruto (% e PBB-së)	22,0	28,1	27,5	25,9	26,4
Borxhi bruto qeveritar (% e PBB-së)	70,0	72,7	72,2	70,0	67,2
Papunësia (% e popullatës)	17,9	17,1	15,2	13,8	12,3
PBB nominale (miliard \$)	13,2	11,4	11,9	13,1	15,2

Burimi: Autoritetet kombëtare, përlogaritjet e FMN dhe BERZH

- **Rritja e PBB-së është përgjysmuar pas krizës dhe është ndikuar kryesisht nga konsumi.** Rritja ekonomike pas krizës ka rënë në më pak se 3% nga mbi 6% në periudhën 2000-2008. Rritja në 10 vitet e fundit ka ardhur kryesisht nga konsumi familjar, ndjekur nga eksportet neto, ndërsa kontributi i investimeve mbetet i dobët. Megjithatë, gjatë katër viteve të fundit ka një ecuri pozitive të rritjes si dhe të investimeve (megjithëse këto janë përqendruar në dy IHD të mëdha në fushën e energjisë).
- **Në periudhën afatshkurtër ka gjasa për rritje të mëtejshme, por me ritme më të ulëta.** Rritja arriti 4,1% në 2018, kryesisht si rezultat i kushteve të mira hidrologjike dhe rrjedhimisht prej prodhimit më të lartë të energjisë elektrike. Gjithashtu, turizmi është një kontribues gjithnjë e më i rëndësishëm për rritjen ekonomike. Ekonomia për vitin 2019 parashikohet të rritet me 2,8%, kryesisht si rezultat i konsumit privat, dhe të përshpejtohet në 3,5% në 2020, ndihmuar nga baza e ulët e prodhimit të elektricitetit në vitin paraardhës dhe duke supozuar rritje të mëtejshme në turizëm dhe investime në infrastrukturën e transportit. Megjithatë, ka rrezik për rënie, për shkak të ngadalësimit ekonomik të Italisë dhe pjesës tjetër të zonës euro, vonesave të mëtejshme në fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, dhe rreziqeve të brendshme (borxhi i lartë publik dhe detyrimet që lindin nga PPP-të e pakërkua, dhe mungesa e gjatë e stabilitetit politik).
- **Për të përshpejtuar përafrimin me nivelin e të ardhurave të BE-së, Shqipëria duhet të risë prodhimtarinë, duke transferuar modelin e rritjes nga konsumi drejt investimeve dhe eksportit.** PBB-ja reale për frymë e Shqipërisë është më pak se një e treta e mesatares së BE-së dhe më pak se gjysma e asaj të vendeve të reja anëtare të BE-së. Konvergjenca më e shpejtë kërkon prodhimtari më të lartë, sidomos në kuadrin e zhvillimeve jo të favorshme demografike. Përmirësimi i klimës së biznesit (përfshirë forcimin e institucioneve dhe sundimit të ligjit), infrastruktura e përmirësuar, eliminimi i paqartësive lidhur me të drejtat mbi tokën dhe pronën, si dhe adresimi i mangësive të fuqisë punëtore dhe emigrimit të gjerë, do të mbështesnin zhvillimin shumë të nevojshëm të sektorit privat.

2. Konteksti Ekonomik

2.2 . Sfidat Kyçe të Tranzicionit




European Bank
for Reconstruction and Development

Konkurrues (5,0)

- Ekonomia informale e përhapur, që krijon konkurrencë të padrejtë
- Kosto e ulët e fuqisë punëtore...
- ...por edhe prodhimtaria e ulët për shkak të mungesës dhe mospërputhjes së aftësive, mungesa e njohurive dhe sofistikimit të biznesit, investimi i ulët në K&ZH, kapaciteti i dobët për inovacion në ekonomi
- Shkallë e ulët diversifikimi ekonomik
- Integrim i dobët në ZGV
- Mjedis jo i volitshëm biznesi: Renditur e 82-ta nga 190 vende për lehtësinë e të bërit biznes (BB 2020)
- Qasje e vështirë në financim, sidomos për SMVM-të

Lehtësia e të bërit biznes (pikëzimi)




Burimi: BB - Doing Business 2020

I Mirëqeverisur (5,1)

- Sundim i dobët i ligjit, gjyqësori i dobët dhe jo efikas, dhe zbatim jo-konsistent i ligjeve dhe rregulloreve
- Reforma në drejtësi në zbatim e sipër, por në mënyrë të ngadaltë çka sjell mbishtim të çështjeve të pazgjidhura
- Të drejta pronësore të dobëta, sidomos sa i përket të drejtave mbi tokën
- Zbatim i dobët i kontratave dhe pengesa të mëdha rregullatore ndaj bizneseve
- Evazion fiskal: një ndër vendet me të ardhurat më të ulëta fiskale në Europë
- Kapacitet i kufizuar i administratës publike dhe reagim i dobët ndaj nevojave të biznesit
- Kuadër i dobët i qeverisjes së korporatave

Sundimi i ligjit (nga -2,5 në +2,5 më e larta)




Burimi: BB - Treguesit Botëror të Qeverisjes

I Gjellbër (4,4)

- Mbështetje pothuaj e plotë në prodhimin e luhatshëm të energjisë hidrike, me ndikime të mundshme negative në sigurinë dhe koston e furnizimit me energji
- Potencial në energji të tjera të rinovueshme (diell, erë)
- Përdorim jo i efektshëm i energjisë me humbje të mëdha në shpërndarje
- Intensiteti i energjisë nën mesataren e BP-5 por mbi mesataren e BE-së
- Sektori i transportit është konsumatori më i madh përfundimtar i energjisë
- Administrim i papërshtatshëm i mbetjeve, landfilli të pakontrolluara, riciklim i kufizuar
- Dobësi në trajtimin e kanalizimeve dhe ujërave të zeza
- Ndotje e ajrit në zonat urbane

Burimet parësore të energjisë



Burimi: EUROSTAT

2. Konteksti Ekonomik

2.2 . Sfidat Kyçe të Tranzicionit




European Bank
for Reconstruction and Development

Përfshirës (4,8)

- Papunësi akoma e lartë me vlera dyshifrore, sidomos tek rinia
- Emigrim i madh dhe urbanizim i shpejtë i Tiranës
- Ngushtim i hendekut të punësimit midis gjinive
- Grupet e cenueshme: të rinjtë, gratë, ata me arsim të ulët
- Arsim dhe Formim Profesional i pazhvilluar si duhet
- Shkallë e ulët e kryerjes së arsimit të lartë
- Mospërputhje aftësish për të mirëarsimuarit
- Përfshirje e dobët financiare e burrave dhe grave ku më pak se 40% e popullsisë mbi 15 vjeç ka llogari bankare

Papunësia tek të rinjtë sipas nivelit të arsimimit (%)




Burimi: INSTAT

Rezistent (5,3)

- Sistem financiar i zhvilluar pak dhe i mbizotëruar nga bankat
- Sektor bankar me kapital të bollshëm dhe me likuiditet të mirë, por nivel relativisht i lartë KMP-sh dhe huadhënie të ulët ndaj sektorit privat.
- Euroizim i lartë (më shumë se 50 përqind)
- Ekspozim i lartë i bankave ndaj borxhit sovran
- Tregje kapitali të pazhvilluara, të përbëra thuajse vetëm nga letrat me vlerë të qeverisë
- Vendi qëndron pas EJT-së në lidhjet energjetike brenda vendit dhe midis vendeve, pjesëmarrjen e sektorit privat dhe kuadrin legjislativ
- Më i zhvilluar se EJT në rristurimin dhe ndarjen në sektorin e energjisë

Huatë me Probleme (%)




Burimi: IMF dhe autoritetet kombëtare

I Integruar (5,7)

- Hapje e ulët tregtare, përveç sektorit të shërbimeve
- Eksporti i mallrave i përqendruar si në produkte ashtu edhe tregje
- Produktet kryesore të eksportit: me vlerë të shtuar të ulët, produkte dhe lënde të para me intensitet të lartë fuqie punëtore
- Eksportuesi më i madh i naftës bruto në EJT
- Stok i ulët IHD-sh: më shumë kufizime për IHD-të se në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor
- IHD-të synojnë kryesisht sektorët e burimeve natyrore dhe energjisë
- Infrastrukturë e papërshtatshme transporti, veçanërisht në hekurudha
- Furnizimit me ujë nuk ofron siguri; përqindje e lartë e ujit të pafaturuar (67 përqind)

Tregtia (% e PBB-së)



Burimi: BB - Treguesit Botëror të Qeverisjes

3. Përparësitë e Qeverisë dhe Angazhimi i Palëve të Interesit



European Bank
for Reconstruction and Development

3.1. Përparësitë e Qeverisë për Reforma

- **Energjia:** Liberalizim dhe diversifikim i mëtejshëm i tregut të energjisë duke u përqendruar tek burimet e rinovueshme, ndarja e shpërndarjes nga furnizimi, krijimi i një Burse Shqiptare të Energjisë, investimi në rrjetin e transmetimit dhe në asetet e prodhimit, ulja e humbjeve në shpërndarje dhe përmirësimi i arkëtimit të pagesave, zhvillimi i një kuadri institucional për sektorin e gazit.
- **Transporti:** Rehabilitimi i segmentit hekurudhor Durrës-Tiranë-Aeroporti Rinas, si hap i parë drejt krijimit të një sistemi hekurudhor konkurrues dhe të besueshëm. Zhvillimi i aeroporteve të tjera, ndër të cilët të paktën njëri në jug të vendit. Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrjetit rrugor të vendit për të zhblokuar zhvillimin ekonomik, përfshirë turizmin. Vijimi i investimeve për modernizimin e Portit të Durrësit.
- **Agrobiznesi:** Konsolidimi i tokës bujqësore me qëllim krijimin e femave konkurruese dhe efikase nga pikëpamja ekonomike, dhe promovimi i qasjes në financim.
- **Turizmi:** Zhvillimi i turizmit të trashëgimisë kulturore në bregdet dhe në brendësi të vendit përmes investimeve në infrastrukturë mundësuese dhe konkurrueshmëri në sektorin privat. Vëmendje e veçantë për tërheqjen e IHD-ve dhe zhvillimin e sektorit të agro-turizmit.
- **Mjedisi:** Reformimi i sektorit të ujit dhe ujërave të ndotura, përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe disiplinës së pagesave. Në sektorin e administrimit të mbetjeve, mbyllja e vend-depozitimeve të jashtëligjshme, zhvillimi i landfilleve të përshtatshme, si dhe impianteve djegëse në Tiranë dhe disa qendra rajonale.
- **Klima e investimit dhe zvogëlimi i ekonomisë informale:** Zbatim i plotë i reformës në drejtësi; Forcimi i të drejtave mbi tokën dhe pronën; Pakësimi i ngarkesave rregullore për biznesin dhe rritja e numrit të shërbimeve publike të ofruara përmes internetit; Sigurimi i një regjimi të vetëm dhe transparent ligjor investimi për përmirësimin e qeverisjes dhe parashikueshmërisë.
- **Ekonomia Digjitale:** Zhvillimi i infrastrukturës rajonale me bandë të gjerë duke zbatuar projekte pilot në zona rurale dhe të thella; dhe krijimi i sinergjive me infrastrukturë për shërbimet e tjera utilitare.
- **Fiskale:** Zvogëlimi i informalitetit dhe marrja e masave të mëtejshme për konsolidim fiskal për të arritur synimet afatmesme të uljes së borxhit publik në më pak se 60% e PBB-së në 2021; forcimi i administratës tatimore; zgjerimi i bazës tatimore.
- **Politikat Shoqërore dhe Punësimi:** Përmirësimi i cilësisë dhe mbulimit të Arsimit dhe Fomimit Profesional, ndërkohë që sigurohen lidhje me tregun e punës. Modernizimi i shërbimeve publike të punësimit, rritja e punësimit të grupeve të synuara për përfshirje.

3.2. Fushat e Reformave nga BERZH dakordësuar gjerësisht me Autoritetet

- **Energjia** – fuqizimi dhe qëndrueshmëria e sektorit të energjisë përmes reformave të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin e BE-së (acquis), përmirësimi i qeverisjes dhe aftësive të NSH-ve, dhe mundësimi i diversifikimit të burimeve të energjisë përmes investimeve dhe asistencës teknike.
- **Klima e Investimit** – mbështetje për përmirësimin e klimës së investimit, duke përfshirë uljen e informalitetit dhe barrës së zbatimit të kuadrit rregullator për bizneset. Ndihmë për rritjen e sipërmarrjeve mikro dhe të vogla përmes qasjes në financim dhe aftësi, duke u përqendruar në përmirësimin e transparencës së qeverisjes dhe raportimit financiar.
- **Turizmi** – rritja e konkurrueshmërisë në turizëm përmes investimeve mundësuese në infrastrukturë dhe ngritje kapacitetesh. Adresimi i pengesave kyçe: qasja në financim, njohuritë dhe fuqia e aftë punëtore.

3.3. Mesazhet Kryesore nga Shoqëria Civile për BERZH

- **Qëndrueshmëria** – Mbështetja për energjinë e rinovueshme shihet si përparësi si në nivelin e dialogut të politikave edhe atë të investimit, si në shkallë industriale ashtu edhe rezidenciale (p.sh., përdorimi i paneleve diellore).
- **Qeverisja** – U shprehën shqetësime për zbatimin e Ligjit për Falimentin, veçanërisht lidhur me KMP-të; ndikimin e fushatave kundër informalitetit mbi biznesin e vogël; dhe ndikimin e përgjithshëm të mundshëm të mungesës së stabilitetit politik në ekonomi. Gjithashtu, pritet që BERZH-i të promovojë konkurrencën e drejtë dhe të parandalojë krijimin e monopoleve.
- **Roli i shoqërisë civile** - OSHC-të mund të jenë partnerë të BERZH-it në identifikimin dhe zbatimin e projekteve në nivel bashkie si dhe për të mbështetur sipërmarrjet e grave.

4. Përcaktimi i Përparësive të Strategjisë për Shqipërinë



European Bank
for Reconstruction and Development

Çfarë duhet të ndryshojë? (Diagnostikimi i Vendi)



A mund të ndryshohet? (Ekonomia Politike)



Çfarë mund të bëjë Banka? (Aftësitë Institucionale)

Përparësitë Strategjike (2020-2025)

Çfarë Duam të Shohim në 2025

Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes në të gjithë ekonominë

- Komercializimi dhe ristrukturimi i NSH-ve kyçe; Forcimi i qeverisjes së korporatës së firmave
- Përmirësimi i cilësisë së institucioneve; Forcimi i sundimit të ligjit

Përmirësim i konkurruesmërisë dhe gjithëpërfshirjes së sektorit privat përmes qasjes më të madhe në financim dhe aftësi

- Konkurrencë më e madhe përmes hyrjes/konsolidimit dhe rregullave të barabarta; Qasje më e madhe në financim e sipërmarrje
- Aftësi të përmirësuar biznesi, standarde dhe sofistikimi biznesit; Qasje në krijimin e aftësive (përfshirë uljen e mospërputhjes së aftësive) që sjellin mundësi punësimi
- Qasje më e madhe në infrastrukturë që krijon mundësi ekonomike për përfshirjen e grupeve të synuara

Përforsim i diversifikimit të energjisë dhe tranzicionit drejt niveleve të ulta të karbonit

- Energi më e diversifikuar më pak e cënueshme nga ndryshimet klimatike
- Rrjetë të përforsuara për lidhjen vendase dhe rajonale

- Kapaciteti i zbatimit të investimeve në infrastrukturë është i ulët, ndërkohë që infrastruktura kërkon rehabilitim dhe zgjerim të konsiderueshëm.
- Në të shkuarën janë miratuar PPP të hartuara dobët dhe të pakërkua.
- Sundimi i dobët i ligjit dhe kapaciteti i ulët në sistemin gjyqësor kufizojnë zhvillimin e sektorit privat.
- Thuajse një e treta e popullsisë nuk ka qasje në ujë të sigurt dhe të pastër.

- Zhvillimi i sektorit privat vuan nga informaliteti i shumëpërhapur dhe konkurrueshmëria e ulët.
- Produktet kryesore të eksportit kanë vlerë të shtuar e ulët, janë produkte me intensitet të lartë fuqie punëtore dhe lëndët e parë
- Mospërputhja e madhe e aftësive, përfshirë edhe për rininë e mirëarsimuar, përkeqësohet nga emigrimi i madh për shkak të varfërisë, mungesa e vendeve të punës dhe arsimit më cilësor të dobët. Me gjithë mungesën e fuqisë punëtore, papunësia mbetet e lartë.
- Shqipëria ka një prej stokeve më të ulëta të IHD-së në Evropë, veçanërisht i ulët në prodhim, dhe është vendi me më pak integrim në zinxhirët global të vlerës në EJT.

- Prodhimi i energjisë mbetet thuajse tërësisht i varur nga burimet hidrike, çka sjell rreziqe që lidhen me importin e shtrenjtë të energjisë në periudha me reshje të pakta.
- Investimet në eficiencën e energjisë janë të pakta.
- Cënueshmëria nga ndryshimet klimatike është e konsiderueshme.

- Nevojat për investime dhe reforma përkatëse në infrastrukturë janë të pranuar nga palët. Taksimi rrugor filloi të aplikohet në shtator 2018.
- Autoritetet janë të gatshme të punojnë ngushtë me IFN-të për të çuar përpara investimet në infrastrukturë.
- Ka ecuri pozitive me zbatimin e propozimeve të Këshillit të Investimeve.

- Masat qeveritare kundër informalitetit, përfshirë deklarimin e taksave në internet dhe fushatat anti-informalitet, kanë sjellë disa rezultate pozitive.
- Eksporti i shërbimeve (kryesisht falë turizmit) është rritur pesëfish që prej fillimit të viteve 2000, dhe përbën ¼ e PBB-së, nivel më i lartë se ai i BE-11 dhe BP-5.
- Pranohet nevoja për përmirësimin e aftësive, por cilësia e arsimit mbetet e ulët; po ashtu pak është bërë për të administruar largimin e trurit.
- Dy projekte madhore energjetike kanë sjellë rritje të ndjeshme në stokun e IHD-ve në tre vitet e fundit, megjithëse niveli i përgjithshëm mbetet shumë i ulët.

- Përpjekje po bëhen për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, diversifikimin e burimeve të energjisë, ndarjes së shpërndarjes nga furnizimi, dhe forcimin e integritetit rajonal.
- PVQJG me Tiranën është dakordësuar dhe është nënshkruar transaksioni i parë jo sovran bashkiak i mundësuar nga rritja e tarifës së ujit.

- Përvojë e gjerë në përgatitjen dhe zbatimin e investimeve në infrastrukturë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare në të gjithë rajonin.
- Vëmendje të veçantë ndaj përmirësimit të qeverisjes për klientët e BERZH-it, përfshirë planet e veprimit financiar dhe operacional, si dhe të qeverisjes së korporatës.
- Shërbime të përzgjedhura këshillimi për politika në kuadër të NKIM-së.

- Vëmendje të veçantë ndaj mbështetjes së sektorit privat përmes një kombinimi financiar, këshillimi dhe angazhim në politika për të përmirësuar mjedisin e biznesit.
- Mbështetje e mirë hartuar financiare dhe këshillimi për klientët e sektorit privat, përfshirë financimin e drejtpërdrejtë si dhe jo të drejtpërdrejtë dhe ndarjen e rrezikut përmes institucioneve financiare dhe KBV. Qasje ndaj investimit e përqendruar tek krijimi i aftësive dhe hapja e vendeve të punës.
- Mbështetje për klientët në zbatimin e programeve të mësimi bazuar në vendin e punës dhe trajnimeve cilësore gjatë punës, për të përmirësuar punësimin e mbyllur hendekun e aftësive.

- Mbështetje për diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike, veçanërisht diellore, erë dhe gaz.
- Vëmendje në rritje ndaj zgjerimit të rrjeteve të gjelbra për të mundësuar sigurinë e energjisë në sisteme të ndërmjetme të energjisë së rinovueshme.
- Promovimi i qyteteve të qëndrueshme dhe inteligjente, përfshirë Programin e Qyteteve të Gjelbra.

5. Aktivitetet dhe Kuadri i Rezultateve

Përparësia 1: Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes në të gjithë ekonominë

Objektivat Kryesorë	Aktivitetet	Treguesit e Progresit (Rezultatet)
Komercializimi dhe ristrukturimi i NSH-ve kyçe; Forcimi i qeverisjes së korporatës së firmave	- Ristrukturimi i NSH-ve të përzgjedhura në energji, transport dhe ujë/ujëra të ndotur, përmirësimi i qeverisjes së tyre të korporatës dhe praktikave të biznesit. - Mbështetje për zhvillimin e sektorit të gazit, përfshirë ngritjen e kapaciteteve të OST-së së sapo krijuar të gazit, Albgaz, dhe angazhimin në politika për kuadrin rregullator.	- Rekomandime për politikat të pranuar dhe të zbatuara nga autoritetet dhe palët përkatëse të interesit - Qeverisja e korporatës për firmat e mbështetura e përmirësuar (numri i firmave/raport cilësor)
Përmirësimi i cilësisë së institucioneve; Forcimi i sundimit të ligjit	- Financim për infrastrukturën ndërkohë që forcohen kuadri institucional dhe praktikat përkatëse të prokurimit. - Vijim i mbështetjes për Këshillin e Investimeve dhe për zbatimin e rekomandimeve të tij, përmes AT me objektiva të mirë përcaktuar, përfshirë mbështetje për autoritetin e konkurrencës dhe reformën në inspektimin e bizneseve. - Mbështetje për zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet trajnimeve gjyqësore.	- Përmirësimet ligjore/institucionale/rregullatore në fushat e klimës së investimit dhe qeverisjes - Numri i gjyqtarëve / zyrtarëve të trajnuar

5. Kuadri i Aktiviteteve dhe Rezultateve

Përparësia 2: Përmirësim i konkurrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes së sektorit privat përmes qasjes më të madhe në financim dhe aftësi

Objektivat Kryesorë	Aktivitetet	Treguesit e Progresit (Rezultatet)
Konkurrencë më e madhe përmes hyrjes/konsolidimit dhe rregullave të barabarta; Qasje më e madhe në financim e sipërmarrje	- Financim i kompanive private nëpërmjet instrumenteve të financuara dhe të pafinancuara, përfshirë linjat e huadhënies, ndarjen e rrezikut, dhe financat tregtare, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjithë sektorët. - Mbështetje e përfshirjes ekonomike të grave, të rinjve, dhe rajoneve të ndryshme, nëpërmjet financimit të dedikuar, aktiviteteve këshilluese si dhe promovimit të prokurimit gjithëpërfshirës - Përmirësim i kapaciteteve të IFP-ve, përmes AT, për të zhbllokuar huadhënien ndaj sektorit privat. - Vijim i zbatimit të IMASH-it për të përmirësuar qasjen në financim për sektorin e agrobiznesit, përfshirë përmes AT dhënë IFP-ve.	- Numri/volumi i huave të dhëna SMVM-ve nga institucionet financiare partnere (edhe sipas grupeve të synuara për përfshirje) - Numri i klientëve raportojnë rritje të të ardhurave / punësimit
Aftësi të përmirësuar biznesi, standarde dhe sofistikim i biznesit; Qasje në krijimin e aftësive (përfshirë uljen e mospërputhjes së aftësive)	- KBV të përmirësojë performancën dhe standardet e SVM-ve si dhe gatishmërinë e tyre për të investuar. KBV do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të SVM-ve në fushat e menaxhimit dhe raportimit financiar, aftësitë e biznesit në të gjithë sektorët me përparësi dhe në grupet e synuara për përfshirje. Mbështetje për rritjen e SVM-ve me potencial të lartë, kombinuar me qasjen në financim. - Ndihmesë në krijimin e një këshilli aftësish në sektorin e turizmit me pjesëmarrjen e palëve kryesore të interesit, si publike ashtu edhe private, duke përfshirë edhe përforcimin e Arsimit dhe Formimit Profesional përkatës.	- Numri i klientëve që përmirësuan standardet sipas objektivave (edhe sipas grupeve të synuara për përfshirje) - Numri i përgjithshëm i njerëzve që marrin aftësi të përmirësuar (edhe sipas grupeve të synuara për përfshirje)
Qasje më e madhe në infrastrukturë që krijon mundësi ekonomike	Financim i infrastrukturës mundësuese për turizmin, si uji, administrimi i ujërave të ndotur, rrugë dhe shërbime bashkiake, në bashkëpunim me BE-në, IFN të tjera dhe donator, përfshirë dizenjimin gjithëpërfshirës e me perspektivë gjinore të shërbimeve kyçe.	Rritje neto e përdorimit dhe/ose kapacitetit të infrastrukturës

5. Kuadri i Aktiviteteve dhe Rezultateve

Përparësia 3: Përforcim i diversifikimit të energjisë dhe tranzicionit drejt niveleve të ulta të karbonit

Objektivat Kryesorë	Aktivitetet	Treguesit e Progresit (Rezultatet)
Emetime të reduktuara të CO2, efikasitet më i madh energjie dhe burimesh dhe rezistencë e përmirësuar ndaj klimës	- Mbështetje për diversifikimin e furnizimit me energji, përfshirë përmes financimit të gazit dhe kapaciteteve shtesë të rinovueshme, sidomos prodhimit të energjisë diellore dhe nga era, si edhe angazhim në politika dhe AT për shpërndarjen konkurruese të kapaciteteve - Promovim i tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër, dhe mbështetje që Shqipëria të përmbushë kontributet kombëtare të përcaktuara. - Financim i efikasitetit të burimeve dhe energjisë përmes linjave të huadhënies, ndarjes së rrezikut si dhe drejtpërsëdrejti, së bashku me këshillim nëse është e nevojshme. - Vijimi i Nismës së Qyteteve të Gjelbra në Tiranë, përfshirë investimet ndjekëse, përmirësimin e transportit urban dhe rigjenerimin urban. - Përmirësim i rezistueshmërisë së infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike si pjesë e projekteve për zhvillimin e infrastrukturës. - KBV të forcojë këshillimin në efikasitet energjie dhe në tranzicionin drejt modeleve ekonomike qarkulluese.	- CO2 i reduktuar/shmangur gjithsej (ton/vit) - Kapaciteti i përgjithshëm i energjisë diellore, me erë, ose gaz i instaluar (MW)
Rrjete të përforcuara për lidhjen vendase dhe rajonale	- Financim i investimeve në transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë për uljen e humbjeve dhe zgjerimin e rrjeteve, mbështetje për Shqipërinë në integrimin në tregun rajonal të energjisë, dhe vijim i dialogut për politikat përkatëse. - Angazhim më i gjerë në politika në sektorin e energjisë, përfshirë për të thelluar liberalizimin e tregut dhe për të vijuar ndarjen e sektorit të energjisë elektrike në përputhje me Paketën e Tretë të Energjisë të BE-së, dhe politika e aktiviteteve të tjera relevante (p.sh.. Marrëveshja e Gjelbër Evropiane). - Financim i infrastrukturës së transportit për përforcimin e ndërlidhjes kombëtare dhe ndërkombëtare.	Kapacitete infrastrukturore të përmirësuar/të shtuara (përfshirë rritjen e përgjithshme neto të kapacitetit, nëse relevante) përmes projekteve të mbështetura nga Banka

6. Harta e Aktiviteteve Plotësuese të Partnerëve Ndërkombëtarë në Fushat e Veprimtarisë së BERZH

FUSHAT E VEPRIMTARISË SË BERZH

		Sektorët								Temat e Ndërthurura				
		Industria, Tregtia dhe Agrobiznesi					Infrastrukturë e Qëndrueshme	Institucionet Financiare		Nismat Strategjike				
Vlera ilustruese të nvestimeve/granteve vjetore (Mesataret e 2015-2019 nëse nuk përcaktohet ndryshe, përfshirë mbështetjen për buxhetin)		Agrobiznesi	TIK	Prodhimi dhe Shërbimet	Burimet natyrore	Pronat dhe Turizmi	Energjia	Infrastruktura	Veprimtaria Bankare	Institucionet Financiare jo Banka	Ekonomia e Gjelbër	Përfshirja dhe Gjinia	Valuta Vendase dhe Tregjet e Kapitalit	Biznesi i Vogël
BE	107	€P				€P	P	€P			€P	€P		
Banka Botërore	76	€				€	€P	€P		€	€P	€P	P	
KfW	70	€					€P	€P	€		€			
EIB	28				€			€						
BERZH	123	€			€P	€P	€P	€P	€		€P	€P	P	€

€ Fushë me investime të konsiderueshme ● Përqendrim kryesor në sektorin privat

P Fushë me angazhim të konsiderueshëm në politika ○ Përqendrim kryesor në sektorin publik

Fushat e Mundshme të Bashkëpunimit



Konkurrues:

Shfrytëzimi i financimit në formë grantesh nga BE-ja dhe donatorë të tjerë për të mbështetur qasjen në financim dhe aftësi në sektorë kyç të ekonomisë shqiptare, si turizmi dhe agrobiznesi.



I Integruar:

Në kuadrin e IIBP-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me BEI-në dhe BB-në, të vijohet mbështetja për zhvillimin e infrastrukturës ndërlidhëse kyçe.



Rezistent:

Të vijohet dialogu i politikave dhe AT që mbështesin reformat në sektorin e energjisë, në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, BB-në dhe KfW.



I Mirëqeverisur:

Përmes platformës së këshillimit të siguruar nga Këshilli i Investimeve, të vijohet dialogu i politikave dhe AT që mbështesin klimën e përmirësuar të biznesit në vend, në bashkërendim të ngushtë me BE-në, SECO-n, BB-në dhe KfW-në.



I Gjelbër:

Vijim i financimit të investimeve në kuadrin e PVQJ për Tiranën, në bashkëpunim me IFN-të dhe donatorët e tjerë. Investimet mjedisore duhet gjithashtu të jenë përbërës të rëndësishëm të programit për konkurrueshmërinë e turizmit me BE-në.

Shënim: Hartëzimi i veprimtarisë së IFN-ve bazuar në informacionin publik të disponueshëm.

Shënim: IMASH është përfshirë edhe në Bankingun e IF-ve edhe në Agrobiznes, duke qenë se është projekt i përbashkët.

Investimet konsiderueshme nga IFN-të përcaktohen si projekte me investim vjetor më shumë se 5% dhe nënshkruar që prej 2016-ës.

7. Risqet e Zbatimit, dhe Implikimet Mjedisore dhe Sociale

Risqe ndaj Zbatimit të Strategjisë	Probabiliteti	Efekti	Implikime Mjedisore dhe Sociale
Ngadalësim në procesin e përafrimit me BE-në dhe reformat përkatëse			• Vlerësimi dhe Administrimi i Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale: Sigurohemi që ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe kumulative të projekteve dhe instrumenteve të shoqëruara me to të vlerësohen siç duhet në përputhje me Direktivën e BE për VNM-të dhe KP-të e BERZH-it. Mbështetje për klientët që të forcojnë kapacitetin e administrimit M&S dhe të publikojnë raportet
Mungesa e stabilitetit politik që sjell mungesë fokusi dhe mungesë vazhdimësie në politikat e Qeverisë			• Kushtet e Punësimit dhe Punës: Sigurohemi që politikat dhe praktikatat e BNJ-së të klientëve dhe palëve të treta relevante janë në përputhje me kërkesat e BERZH dhe BE që promovojnë mundësi të barabarta dhe përfshirje ekonomike, që respektojnë të drejtat e punësimit, administrojnë ndikimet e shkurtimeve në shkallë të gjerë dhe parandalojnë diskriminimin e mundshëm ndaj pakicave dhe grupeve të tjera të cënueshme.
Kapacitete të dobëta dhe ndryshime të shpeshta personeli në administratën publike			• Efikasiteti i Burimeve dhe Parandalimi dhe Kontrolli i Ndotjes: Ka ende sfida në mbledhjen dhe administrimin e mbetjeve dhe ujërave të ndotur, si dhe në ndotjen e ajrit. Mbështetje për klientët që të jenë në përputhje me Direktivat përkatëse të BE-së dhe të përmirësojnë efikasitetin e proceseve specifike të industrisë në përputhje me TMD.
Ngecje e reformave në sektorin e energjisë që kufizon liberalizimin dhe investimet			• Shëndeti dhe Siguria: Synojmë të përmirësojmë standardet e SH&S në të gjithë sektorët. Siguria rrugore dhe e trafikut, përfshirë rreziqet që lidhen me projektet e turizmit, janë çështje parësore dhe angazhimi me klientët dhe palë të tjera interesi mund të jetë i nevojshëm. Mund të jenë të nevojshme fonde AT për të mbështetur këto veprimtari.
Zhvillimi i projekteve infrastrukturore kyçe përmes proceseve jo konkurruese dhe të përgatitura dobët			• Blerja e Tokës, Risistemimi i Pavullnetshëm dhe Zhvendosja Ekonomike: Sigurohemi që të jetë kryer restaurimi efikas i mjeteve të jetesës dhe një angazhim i plotë me të gjithë personat e ndikuar nga projektet që kërkojnë risistemim të pavullnetshëm të shkaktuar nga zhvendosja fizike dhe/ose ekonomike, në përputhje me kërkesat e BERZH, përfshirë rastet kur nuk ka një certifikatë pronësie.
Përkeqësim i mjedisit të biznesit që çon në dobësim të IHD-ve			• Rruajtja e Biodiversitetit dhe Administrimi i Qëndrueshëm i Burimeve të Gjalla Natyrore: Ka ende sfida që lidhen me nevojën për të marrë në konsideratë të përshtatshme rreziqet e mundshme dhe ndikimet e veprimtarive të projektit mbi florën, faunën, shërbimet e ekosistemeve dhe/ose zonat e mbrojtura ligjërisht ose të njohura ndërkombëtarisht me vlerë biodiversiteti dhe që janë të ndjeshme. Janë të nevojshme fonde BT për ndërgjegjësim lidhur me praktikatat e mira ndërkombëtare si në sektorin publik, ashtu edhe me partnerët në sektorin privat.
			• Trashëgimia Kulturore: Sigurohemi për kryerjen e vlerësimeve të përshtatshme dhe këshillimin e klientëve me palët kyçe të interesit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
			• Ndërmjetësit Financiarë: Sigurohemi që IF-të partnere të forcojnë kapacitetin dhe sistemet e administrimit të riskut të M&S.
			• Angazhimi i Palëve të Interesit: Mbështetje për klientët me hartimin dhe zbatimin e planeve të angazhimit të palëve të interesit dhe sigurojmë këshillim transparent me pjesëmarrje si pjesë e leje-marrjes vendore dhe VNMS-ve.

8. Vlerësimi i Bashkëfinancimit nga Donatorët

8.1. Vlerësimi i Nevojave për Periudhën e Strategjisë së Re

Financimi nga donatorët do të jetë i nevojshëm për arritjen e objektivave strategjikë të Strategjisë për Vendin, përfshirë edhe për:

- Përmirësimin e klimës së investimit dhe qeverisjes së korporatës, përfshirë përmes nismave të ngritjes së kapaciteteve për forcimin e institucioneve dhe mbështetjen për reformën në gjyqësor.
- Bashkëinvestime dhe grante për mbulimin e riskut të humbjes së parë, si dhe për mbështetjen në zbatimin e promovimit të qasjes në financim, përfshirë përmes programeve të huadhënies së ndërmjetësuar me IFP-të.
- Shërbimet këshilluese për përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe mbështetjen e rritjes së SVM-ve me potencial të madh.
- Mbështetje me grante për projektet infrastrukturore që përmirësojnë ndërlidhjen vendase dhe rajonale si dhe potencialin e turizmit, përfshirë në sektorët e energjisë, rrugor dhe detar.
- Mbështetje për përgatitje dhe zbatim projektsh investimesh që promovojnë tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër dhe eficiencën e burimeve, përfshirë në sektorin e energjisë së rinovueshme.


Treguesit e Përzgjedhur të Përbalueshmërisë

Klasifikimi sipas përqindjes rajonale e BERZH¹

PBB për frymë (PPP, aktual \$) ²	13.345	I 31-ti (CoO)
Vend AZZH	PO	Nuk Aplikohet
AZZH si pjesë e të Ardhurave Kombëtare Bruto (%) ³	1,2	I 28-ti
AZZH për frymë (\$ - çmimet aktuale) ³	54,76	I 40-ti

Burimet: ² FMN (2018), ³ OECD (2017)

Financimi i donatorëve gjatë strategjisë së fundit (mil €)⁴




* Vlerësim paraprak

8.2. Burimet e Mundshme të Fondeve nga Donatorët

- **Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (IIBP):** Një nismë e përbashkët e qeverive përfituese, BE-së, donatorëve bilateral dhe IFN-ve. AT dhe mbështetje me grante bashkëinvestimi janë në dispozicion për investimet me përparësi në projekte zhvillimore në sektorët e transportit, energjisë, mjedisit, digjital, shoqëror dhe privat.
- Përveç fondeve të kanalizuar përmes IIBP-së, fonde të tjera të **IAP-s së BE-së** mund të jenë gjithashtu të disponueshme. Në kuadrin e IAP II, fushat me përparësi për Shqipërinë përfshijnë infrastrukturën, qeverisjen, reformën ligjore, mjedisin, konkurrueshmërinë dhe zhvillimin bujqësor dhe rural. Fondet e disponueshme në kuadrin e IAP III do të nisin të mobilizohen në 2021.
- Shqipëria do të mund të marrë financim nga **Fondi i Klimës së Gjelbër** në kuadrin e Instrumentit të Qyteteve të Gjelbra të BERZH-it, si për asistencë teknike, ashtu edhe për investime në infrastrukturë të gjelbër.
- **Shqipëria** është edhe vetë donatore dhe ka angazhuar deri në 36 mil € deri tani për mbulimin e rrezikut nga humbja e parë, për të përmirësuar qasjen e agrobiznesit në financim në kuadrin e IMASH-së.
- Do të vijohet të kërkohet mbështetje nga donatorë të tjerë **bilateralë** (si SECO, Suedia dhe Italia). Fondet mund të kanalizohen edhe përmes **Llogarive të Donatorëve të Shumëfishtë** si Fondi për Ndikimin e Biznesit të Vogël.

Nevojat Aktuale për Financim nga Grante⁵



1. Klasifikimi i thjeshtë sipas përqindjes, raportuar si pjesë e vendeve të BERZH (CoO me ODA në rastin e treguesve të ODA-së) që përfaqësohen poshtë Shqipërisë.

4. Të dhënat për BT 2016-2018 bazohen në përcaktimet në nivel projekti. Shumat e granteve të bashkëinvestimit bazohen në nënshkrimet nga klientët.

5. Nevojat e financimit të përlogaritur me grante duhet të bazohen në nevojat funksionale të raportuara nga ekipet e bankave për projektet që do të nisin në 2019. Nevojat e financimit të përlogaritur me grante zakonisht tejkalojnë përdorimin faktik të granteve, duke qenë se disa nevoja mund të mos lindin, mund të vonojnë, ose mund të ndahen në disa vite të përplekëve të mbledhjes së fondeve për shkak të nevojave funksionale dhe realiteteve.



SHTOJCAT

Angazhimi i Shqipërisë ndaj parimeve politike të përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për Krijimin e Bankës dhe zbatimin e tyre, kanë vijuar që prej miratimit të Strategjisë së mëparshme për Vendin, në përputhje me përpjekjet për zbatimin e agjendës gjithëpërfshirëse të reformave të BE-së.

Kuadri kushtetues dhe legjislativ për një demokraci parlamentare pluraliste ekziston. Sipas vlerësimit të Këshillit të Europës, ndarja e pushteteve dhe kontrollet dhe ekuilibrat në sistemin politik, garancitë për të drejtat themelore dhe mbrojtjen e pakicave dhe për një rol kuptimplotë të shoqërisë civile janë gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe europiane.

Në periudhën që prej miratimit të Strategjisë së mëparshme, Shqipëria ka përparuar më tej me reformat demokratike. Janë bërë përmirësime në fusha që konsideroheshin si dobësi kyçe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si sundimi i ligjit dhe reforma e administratës publike. Në veçanti, autoritetet kanë ndërmarrë një reformë rrënjësore të sistemit gjyqësor, që u hartua për të rritur pavarësinë, profesionalizmin dhe efektshmërinë e tij, dhe kanë shtuar përpjekjet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe masa kundër trafikimit dhe kultivimit të lëndëve narkotike.

Progresi në reformat demokratike i arritur nga autoritetet shqiptare është pasqyruar në vlerësimet përkatëse nga Komisioni Europian në kuadër të shqyrtimit të përpjekjeve të Shqipërisë për përafrim me BE-në. Në maj 2019, pasi vlerësoi se vendi kishte bërë progres të mjaftueshëm me reformat, Komisioni Europian i drejtoi një rekomandim zyrtar Këshillit Europian për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE. Megjithatë, në mbledhjet e Këshillit Evropian në qershor dhe tetor 2019 nuk u arrit konsensus për këtë çështje. Si pasojë, më 18 tetor 2019, Këshilli Europian vendosi të shtyjë vendimin dhe ti kthehet përsëri kësaj çështjeje në Samitin BE-Ballkan Perëndimor në maj 2020.

Me gjithë progresin e lartpërmendur, ka ende sfida të konsiderueshme, përfshirë nevojën për prova të qarta të kryerjes së hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në kuadrin e luftës kundër korrupsionit në të gjitha nivelet dhe në luftën kundër krimit të organizuar. Nevojiten përpjekje të mëtejshme të qëndrueshme për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe adresimin e ekonomisë informale. Një sfidë tjetër është atmosfera e vazhdueshme e polarizuar politike në vend.

Zgjedhjet e Lira dhe Qeveri Përfaqësuese

Zgjedhje të lira, të drejta dhe konkurruese

Zgjedhjet në Shqipëri mbahen zakonisht të tilla që nga ana e OSBE-së dhe Këshillit të Europës vlerësohen kryesisht si të lira, të drejta dhe konkurruese. Kuadri ligjor siguron një bazë të shëndoshë për zgjedhje demokratike, kur ka vullnet politik për zbatimin e përshtatshëm të tij. Ky kuadër ka përfutur nga një sërë reformash zgjedhore, përfshirë ndryshime të mëdha bazuar në rekomandimet e Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Komisioni i Këshillit të Europës për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias). Tre zgjedhjet e fundit të përgjithshme në Shqipëri (2009, 2013, 2017) ishin paqësore, çka përbën një arritje të rëndësishme krahasuar me zgjedhjet e mëparshme që ishin shoqëruar shpesh me dhunë.

Shtojca 1 - Vlerësimi Politik në Kontekstin e Nenit 1

Megjithatë, mangësitë procedurale dhe akuzat për blerje votash dhe trysni ndaj votuesve, si dhe politizimi i skajshëm vijnë të dëmtojnë besimin e publikut në procesin zgjedhor. OSBE/ODIHR kanë rekomanduar një sërë masash shtesë, për ti përafruar më shumë zgjedhjet në Shqipëri me angazhimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Sipas Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, zgjedhjet e fundit të përgjithshme të mbajtura më 25 qershor 2017 u zhvilluan kryesisht në mënyrë të rregullt, ku kundërshtarët patën mundësi të bëjnë fushatë lirisht, megjithëse u vunë re disa parregullsi dhe mangësi procedurale. Këto përfshinin raste të votimit për të tjerë dhe ndërhyrje nga aktivistë të paautorizuar të partive. Mbi të gjitha, procesi zgjedhor vijon të ndikohet negativisht nga politizimi i organeve dhe institucioneve që lidhen me zgjedhjet.

Raporti përfundimtar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017 i hartuar nga OSBE/ODIHR paraqiti një sërë rekomandimesh të detajuara për t'u marrë në konsideratë nga autoritetet, partitë politike dhe shoqëria civile. Ndër të tjera, lista e rekomandimeve me përparësi përfshin një thirrje për të ndërmarrë reforma të mëtejshme zgjedhore me qëllim përfshirjen e rekomandimeve të OSBE-së dhe harmonizimin e ligjeve të ndryshme që lidhen me zgjedhjet; trajtimin e çështjes së vazhdueshme të blerjes së votës; heqjen e kufizimit të të drejtës së votës (lidhur me moshën dhe shëndetin mendor); dhe garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë vëzhguesit.¹

Zgjedhjet e fundit vendore, të mbajtura më 30 qershor 2019, u zhvilluan në kuadrin e një polarizimi politik të tejskajshëm. Partia kryesore opozitare i bojkotoi zgjedhjet, ndërsa Presidenti i vendit dekretoi shtyrjen e tyre për një datë tjetër. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte shumë e ulët. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR, megjithëse u shpreh se votimet u zhvilluan në mënyrë përgjithësisht paqësore dhe të rregullt, theksoi se këto zgjedhje “u mbajtën duke mos treguar thuajse aspak konsideratë për zgjedhësit”.²

Ndarja e pushteteve dhe kontrole dhe ekuilibra efikas

Sipas vlerësimit të Këshillit të Europës, kuadri kushtetues dhe legjislativ për një demokraci parlamentare, që bazohet në ndarjen e pushteteve dhe kontrole dhe ekuilibra në sistemin politik, në një legjislaturë të pavarur dhe në procedura të mirëpërcaktuara të mbikëqyrjes parlamentare në fushat e përcaktuara të vendim marrjes, janë të ngritur në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe europiane në Shqipëri. Objekti i pushtetit të legjislaturës për t'i kërkuar llogari qeverisë dhe për të ushtruar mbikëqyrjen parlamentare është gjithashtu gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Parlamenti me një dhomë dhe 140 deputetë zgjidhet për një mandat katër vjeçar, bazuar në një sistem rajonal proporcional me lista të mbyllura. Në përgjithësi, është bërë progres në funksionimin e parlamentit, përfshirë përsa i përket transparencës dhe gjithëpërfshirjen e procesit legjislativ. Megjithatë, parlamenti vuan ende nga bojkote periodike të deputetëve të opozitës. Në shkurt 2019, shumica e deputetëve të opozitës hoqën dorë nga mandatet e tyre në mënyrë të paprecedentë. Në përfundimet e veta për Shqipërinë, Komunikimi i vitit 2019 i KE-së për Politikën e Zgjerimit të BE-së i bëri thirrje partive opozitare të “riangazhohen në mënyrë konstruktive në institucionet demokratike”.³

1. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR, Shqipëri, zgjedhjet parlamentare 25 qershor 2017. Raporti Përfundimtar, fq 24-25.

2. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR, Shqipëri, zgjedhjet vendore 30 qershor 2019 Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake. Fq 1

3. Komisioni Evropian, Komunikimi nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 29 maj 2019, fq 15.

Pushteti i efektshëm i zyrtarëve të zgjedhur për të qeverisur

Shqipëria ka bërë përcaktimet institucionale, ligjore dhe financiare që zyrtarët e zgjedhur të ushtrojnë në mënyrë të efektshme pushtetin për të qeverisur, dhe ata nuk kufizohen përmes fuqive jodemokratike të vetos ose ndikimeve të tjera të papërshtatshme. Ashtu si edhe në shumë vende të tjera në tranzicion, elita politike dhe biznesi kanë prej kohësh marrëdhënie të ngushta. Megjithatë, kjo nuk duket të ndikojë pushtetin e zyrtarëve të zgjedhur për të qeverisur vendin.

Shoqëria Civile, Media dhe Pjesëmarrja

Niveli dhe pavarësia e shoqërisë civile

Është ngritur një kuadër i kënaqshëm ligjor për organizatat e shoqërisë civile (OSHC), që është përmirësuar në vitet e fundit, duke përfshirë ligje që lidhen me funksionimin e organizatave jofitimprurëse. Procesi për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve është relativisht i thjeshtë dhe përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, ka çështje të pazgjidhura lidhur me përkufizimin e veprimtarive jofitimprurëse, raportimin financiar dhe tatimin. Në vitin 2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këshilli, që ka nisur veprimtarinë në fund të vitit 2017, është një mekanizëm këshillimi me qëllim promovimin e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin politikbërës. Bashkëpunimi midis shtetit dhe OSHC-ve është përmirësuar. Përgjithësisht ka këshillim më të rregullt me OSHC-të për politika dhe nisma ligjore, krahasuar me të shkuarën. Megjithatë, proceset e ndjekjes së mëtejshme, duhet të përmirësohen shumë.

Aktualisht, më shumë se 1,600 OSHC janë të regjistruara në autoritetet tatimore të Shqipërisë. Megjithatë, vetëm një numër i vogël OSHC-sh janë të mirëorganizuara dhe mirëfinancuara, kryesisht në qytetet e mëdha. Roli i OSHC-ve ndikohet nga polarizimi faktik ose i perceptuar i OSHC-ve dhe drejtuesve të tyre, që reflekton shkallën e lartë të polarizimit në vend në përgjithësi. Sektori i shoqërisë civile mbetet i fragmentuar dhe tejte i varur nga financimi i donatorëve të jashtëm, ndërkohë që vitet e fundit është vënë re tërheqja e shumë donatorëve të huaj për shkak të riorientimit të tyre në rajone të tjera. E drejta për të krijuar sindikata është e mishëruar në ligj dhe të drejtat e sindikatave dhe të punës respektohen përgjithësisht në praktikë.

Pavarësia dhe pluralizmi i medias që vepron pa censurë

Gjatë viteve të fundit, pluralizmi në media që funksionon e lirë dhe pa censurë, në përgjithësi është rritur. Kuadri ligjor ekziston në pjesën më të madhe dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në Shqipëri funksionojnë më shumë se 250 transmetues dhe 26 gazeta të përditshme, që përbën një nga shifrat më të mëdha për frymë në rajon (megjithëse tirazhi, edhe nëse konsiderohet për frymë, është shumë më i ulët). Tregu mbizotërohet nga media elektronike. Institucioni kryesor mediatik është Radio Televizioni Shqiptar (RTSh) me dy kanalet e veta kombëtare, që janë veçanërisht me influencë në zonat rurale. Ka një sërë kanalesh kombëtare private dhe një numër të madh transmetuesish rajonalë dhe vendorë privatë. Faqet e internetit po zëvendësojnë me shpejtësi shtypin.

Në vitet e fundit është vënë re një rritje e jashtëzakonshme e qasjes në internet. Sipas Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), përqindja e popullatës që ka qasje në internet u rrit nga 60 përqind në vitin 2014 në 73,5 përqind në vitin 2018. Media sociale po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm dhe deri në dhjetor të vitit 2017 rreth 47 përqind e shqiptarëve ishin përdorues aktivë të Facebook.⁴

Kur merret në konsideratë numri i madh i mediave që konkurrojnë në një treg të kufizuar reklamash dhe mungesa e transparencës në financimin e tyre, vëzhguesit e medias kanë ngritur shqetësime lidhur me ndërhyrjen e madhe nga ana e biznesit dhe interesave politikë. Megjithatë ka disa shoqata dhe sindikata gazetarësh, nuk ka ende një organ vetërregullues për median. Një sërë ndryshimesh janë ndërmarrë së fundmi në Kodin Civil dhe Penal që sollën shfuqizimin e dënimeve me burgim për shpifje, megjithatë dekriminalizimi i plotë i shpifjes dhe shpifjes me shkrim nuk është arritur ende.

Kanale të shumëfishta të pjesëmarrjes civile dhe politike

Ekzistojnë kanale të shumëfishta pjesëmarrjeje civile dhe politike, por mungojnë rregullat dhe procedurat e përcaktuara qartë, veçanërisht sa i përket konsultimit publik. Ndërkohë që komisionet parlamentare u kërkojnë shpesh OSHC-ve të ofrojnë ekspertizë, kjo ende bëhet sipas rastit. Dokumentacioni i dorëzuar për konsultimet publike shpesh i paraqitet publikut në afate shumë të shkurtra.

Liria për të themeluar parti politike dhe ekzistenca e opozitës së organizuar

Liria për të themeluar parti politike është e garantuar nga Kushtetuta dhe e zbatuar në terma praktikë, dhe kjo theksohet nga prania e një opozite të konsiderueshme që është e aftë të bëjë fushatë dhe t'i kundërvihet lirshëm nismave qeveritare. Në zgjedhjet e fundit të përgjithshme në Shqipëri morën pjesë 18 parti politike dhe pesë prej tyre fituan vende në parlament. Partia kryesore opozitare kishte (përpara se deputetët e opozitës të dorëzonin mandatet e tyre në shkurt të vitit 2019 në kuadrin e protestës kundër qeverisë të kryesuar nga opozita) 36 përqind të vendeve në parlament dhe përfaqësuesit e saj drejtonin një sërë komisionesh parlamentare.

Sundimi i Ligjit dhe Qasja në Drejtësi

Mbizotërimi i Ligjit

Siguritë e nevojshme legjislative dhe institucionale të nevojshme për mbizotërimin e ligjit janë të përcaktuara. E drejta për një gjykim të drejtë dhe liria kundër ndalimit dhe burgimit arbitrar janë të mishëruara në Kushtetutë dhe në Kodin Penal. Mbizotërimi i ligjit është përmirësuar si rrjedhojë e reformës aktuale gjithëpërfshirëse të sektorit të drejtësisë, përfshirë ristrukturimin institucional dhe rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetingu).

4. ITU <http://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Pages/stat/default.aspx> dhe Statistikat Botërore të Internetit; <http://www.internetworldstats.com/europa.htm#al>

Pavarësia e gjyqësorit

Kushtetuta garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

Reforma gjithëpërfshirëse e gjyqësorit, që ka nisur në vitin 2016 po ecën përpara duke konsoliduar pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin dhe llogaridhënien e tij. Janë ngritur edhe organe të reja të vetë qeverisjes së pavarur të gjyqësorit.

Qeveria dhe qytetarët të barabartë përpara ligjit

Reforma gjithëpërfshirëse e sistemit të drejtësisë po sjell rezultate pozitive në forcimin e parimit që qeveria dhe qytetarët janë të barabartë përpara ligjit.

Politika dhe institucione efikase për parandalimin e korrupsionit

Korrupsioni mbetet një problem serioz. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (CPI) të Transparency International për vitin 2018, Shqipëria është në vendin e 99-të nga 180 vende të vlerësuara, duke u renditur në vendin më të ulët ndër vendet e Evropës Juglindore.⁵

Që prej miratimit të Strategjisë së mëparshme, autoritetet shqiptare kanë shtuar përpjekjet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë luftën e rëndësishme kundër trafikimit dhe kultivimit të drogës. Janë zbatuar dhe kryer një sërë operacionesh të suksesshme në shkallë të gjerë dhe arrestimesh nga organet e zbatimit të ligjit. Megjithatë, siç theksohet edhe në vlerësimin e fundit të KE-së “një sfidë afatgjatë mbetet krijimi i një historiku të fortë me hetime, ndjekje penale dhe dënime proaktive në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet”.⁶

Sipas raportit më të fundit të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) mbi parandalimin e korrupsionit të pjesëtarëve të parlamentit, gjyqtarëve dhe prokurorëve, të botuar në korrik 2018, Shqipëria ka zbatuar kënaqshëm ose ka trajtuar në mënyrë të kënaqshme katër nga dhjetë rekomandimet e përmbajtura në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Katërt. Gjashtë rekomandimet e tjera janë zbatuar pjesërisht. GRECO mirëpriti progresin e vendit dhe inkurajoi autoritetet të vijonin reformat në të gjitha fusha e mbetura.⁷

5. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2018, Transparency International

6. Komisioni Evropian, komunikimi nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 29 maj 2018.

7. GRECO, Raundi i Katërt i Vlerësimit, Shqipëri, 12 korrik 2018.

Të Drejtat Civile dhe Politike

Liria e fjalës, informacionit, besimit fetar dhe ndërgjegjes, lëvizjes, organizimit, tubimit dhe pronës private

Kushtetuta e Shqipërisë dhe legjislacioni përkatës ndalojnë diskriminimin me bazë seks, race, gjuhë, besim fetar, kombësi apo përkatësi shoqërore, prone apo statusi shoqëror. Kushtetuta garanton liritë dhe të drejtat bazë të qytetarëve të njohura nga e drejta ndërkombëtare, ndërkohë që traktatet ndërkombëtare janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme nga gjykatat vendase dhe hierarkia e tyre është më e lartë se sa legjislacioni vendas.

Shqipëria është nënshkruese e të gjitha instrumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Shkalla e lartë e ratifikimit të konventave të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe instrumenteve rajonale për të drejtat e njeriut, përbën arritje të konsiderueshme. Shqipëria ka ngritur edhe kuadrin institucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që përfshin institucionin e Avokatit të Popullit, një sërë organesh dhe këshillash kombëtarë ndërmëdësorë, si dhe sekretariate teknike në ministri të ndryshme. Sfidat kryesore me të cilat përballlet Shqipëria lidhen me sigurimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për zbatimin dhe monitorimin e këtyre instrumenteve.

Garancitë kushtetuese të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar përgjithësisht respektohen, dhe Shqipëria vijon të jetë një shembull i harmonisë fetare në rajon. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, nuk ka fe zyrtare shtetërore dhe të drejtat e të gjitha komuniteteve fetare (kryesorët janë ai mysliman, kryesisht Suni dhe Bektashi, dhe ai i krishterë (ortodoks, katolik dhe protestantë)) janë të garantuara në mënyrë të barabartë.

Një nga problemet kryesore mbetet kthimi i pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist, dhe zgjidhja e çështjeve me certifikatat dhe pronësinë e tokës. Reforma e të drejtave pronësore është thelbësore për konsolidimin e sundimit të ligjit, po aq sa edhe për zhvillimin ekonomik. Në vitin 2019, parlamenti miratoi Ligjin për Kadastrën, që duhet të sjellë përmbylljen e regjistrimit të parë të titujve pronësorë në të gjithë territorin e vendit.

Vlerësimi i fundit i historikut të Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut në kuadrin e Shqyrtimit Periodik Universal të Kombeve të Bashkuara (UPR) u miratua në maj të vitit 2019. Statistikat e këtij cikli nuk janë ende të disponueshme. Gjatë ciklit të mëparshëm, të ndërmarrë në vitin 2014, dy rekomandimet kryesore për Shqipërinë përfshinin të drejtat e fëmijës (33,33 përqind) dhe të drejtat e grave (28,07 përqind). Shqipëria mbështeti 97,66 përqind të 171 rekomandimeve të bëra gjatë procesit të shqyrtimit.⁸

Përfshirja e grave, etnive dhe pakicave të tjera në politikë

Kuadri legjislativ për mbrojtjen e pakicave etnike zbatohet gjerësisht, përfshirë Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit dhe Shprehjes Kulturore. Në vitin 2017, Shqipëria miratoi ligjin kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Pakicat etnike marrin pjesë aktive në jetën politike, përfshirë edhe përmes partive të veta politike. Ato janë më të fuqishme se në disa fqinjë të tjerë rajonalë dhe të integruar në partitë politike të zakonshme (pa bazë etnike).

Shtojca 1 - Vlerësimi Politik në Kontekstin e Nenit 1

Shqipëria nuk ka përbërje etnike aq të shumëllojshme sa shumica e fqinjëve të saj rajonalë. Pakica greke, që është pakica më e madhe etnike zë vetëm pak përqind të popullatës, sipas disa vlerësimeve. Censusi i fundit, i ndërmarrë në 2011, përfshiu për herë të parë pyetjen me zgjedhje të origjinës etnike dhe besimit fetar. Marrëdhëniet ndëretnike në vend mbeten të mira. Pakicat rome dhe egjiptiane, po ashtu si në shumë vende të tjera fqinje, janë grupi më i cenueshëm dhe vijnë të përballen me vështirësi lidhur me qasjen në arsim, strehim dhe punësim.

Elementët legjislativë kyç për barazinë gjinore janë të miratuar në Shqipëri. Ligjet kritike të miratuara në vitet e fundit përfshijnë Ligjin për Barazinë Gjinore në Shoqëri, për Masat Kundër Dhunës, për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithatë, aktet nënligjore dhe zbatimi nuk janë në të njëjtin nivel. Dhuna familjare kundër grave mbetet problem, sidomos në zonat rurale. Në disa komunitete, gratë përballen me diskriminim shoqëror të bazuar në norma shoqërore tradicionale. Gratë kanë një sërë përfaqësuesesh të shquara në nivel kombëtar. Qeveria e krijuar pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 kishte rreth 50 përqind gra në përbërje. Kuota gjinore solli një rritje të përfaqësimit të grave në parlament nga 7 përqind në të shkuarën, në 26 përqind në parlamentin aktual. Në të njëjtën kohë, ka pabarazi midis numrit të grave që janë kandidatë në zgjedhje (40 përqind gjatë zgjedhjeve të fundit të përgjithshme) dhe numrit të vendeve në parlament që zihen nga gratë (26 përqind).

Liria nga ngacmimi, kanosja dhe tortura

Garancitë kushtetuese kundër ngacmimit, kanosjes dhe torturës janë të miratuara dhe zbatohen gjerësisht në praktikë. Një delegacion i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor apo Degradues i Këshillit të Evropës (CPT) vizitoi Shqipërinë në nëntor 2018. Raporti i vizitës periodike është duke u përgatitur. Raporti i fundit, i botuar në maj 2018 pas një vizite të posaçme në vitin 2017 vlerësoi përpjekjet e vazhdueshme të autoriteteve shqiptare për adresimin e rekomandimeve të mëparshme të CPT-së dhe përmirësimin e kushteve të burgimit në institucionet policore. Perceptimi i përgjithshëm është që policia i trajton të dyshuarit me korrektësi, por delegacioni i CPT-së mori disa akuza keqtrajtimi fizik në disa komisarate policie. Komiteti rekomandoi që autoritetet shqiptare të vijnë me forcë përpjekjet për të luftuar të gjitha format e keqtrajtit nga policia.⁹

9. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor apo Degradues i Këshillit të Evropës (CPT).